



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

## E K S T R A K T

**i procesverbalit i mbledhjes së njëmbëdhjetë të Komitetit për Komunitete, mbajtur më 18. 12. 2023, me fillim në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Mirsada Behluli, Nenad Miladinovic, Elmira Nikçi Rexha, Oktay Kurtesh, Kimeta Shok, Adnan Ajeti, Faton Marolli.

**Munguan:** Arton Brahim, Tria Kasumi Berisha.

**Në mbledhje morën pjesë edhe:** Pëllumb Bajçinovci, kryesues i Kuvendit të Kryeqytetit, Klaudia Mula - zyrtare për komunitete në ZKKK.ës,

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e Komitetit znj. Mirsada Behluli me këtë :

## R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së;
2. Ftesë për Kryesuesin e Kryeqytetit z.Pëllumb Bajçinovcin, lidhur me njoftimin dhe vendosjen e koordinimit të përbashkët për punë;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së komunitetit;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës të Komitetit vitin 2024;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të ZKKK-ës për vitin 2023;
6. Projektet e komuniteteve joshumicë për vitin 2024, për investime kapitale të sillen në muajin janar në ZKKK;
7. Raporti i ZKKK-ës për muajin nëntor 2023;
8. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë, lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre;
9. Të ndryshme.

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

### **Pika e parë**

**Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së;**  
Njëzëri u miratua ekstrakti të procesverbalit nga mbledhja e kaluar.



## **Pika e dytë**

### **Ftesë për Kryesuesin e Kryeqytetit z. Pëllumb Bajçinovcin, lidhur me njoftimin dhe vendosjen e koordinimit të përbashkët për punë**

**Mirsada Behluli** – duke përshëndetur dhe falënderuar kryesuesin e Kuvendit z. Pëllumb Bajçinovci ajo në pika të shkurta e njoftoi lidhur me punën e Komitetit për Komunitete gjatë vitit 2023, si p.sh duke u nisur nga mbajtja e takimeve të rregullta të komitetit, realizimi i vizitave në shkolla ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve joshumicë nga komisioni kompetent i komitetit, realizimi i projekteve si p.sh në Bërnice të Poshtme, Slivovë etj.

**Kryesuesi:** duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit tha se sa i përket punës së Komitetit për Komunitete jam i njoftuar në vazhdimësi nga raportet e dërguara përveç raportit final, ndërsa sa i përket realizimit të projekteve dhe premtimet që i kemi nga komunitetet tjera që jetojnë në kryeqytet duhet të përmbushen dhe të ecin përpara. Ai në vazhdim tha se pa dashur ta zgjasë më shumë unë do të jem i gatshëm të marr pjesë në takim sa herë që keni nevojë të jem aty.

**Nenad Miladinovic** - duke përshëndetur kryesuesin dhe të pranishmit tha se meqë unë në këtë Komitet jam qe dhjetë vite dhe ky komitet ka punuar shkëlqyeshëm ku dhe kemi qenë shembull për komitetet tjera, kisha dashur që kjo të vazhdojë prapë, por me përkrahjen tuaj se pa përkrahjen tuaj nuk mund të realizohet ajo, pasi që ky Komitet i takon Kuvendit dhe ju jeni i obliguar ta ndihmoni këtë Komitet. Ai në vazhdim tha se pa dashur ta përsëris atë çka e tha znj. Mirrada me të cilën pajtohem plotësisht, mendoj se nuk është shumë dhe ngarkesë për kryesuesin që bile dy herë në vit të merr pjesë në takim të Komitetit për Komunitete, ndërsa sa i përket bashkëpunimit të komitetit me drejtoritë me të cilat kemi bashkëpunim të mirë tha se ato janë Drejtoria e Investimeve Kapitale, Drejtoria e Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Shëndetësisë.

**Adnan Ajeti** - tha se problemin e vetëm që e kemi është problemi me mbeturina të cilin problem e kam thënë qysh para katër viteve, por asnjë përgjigje nuk kam marr.

**Kimete Shok** tha se po ashtu edhe unë nuk kam diçka tjetër të them përveç se problemi i cili po na mundon të gjithëve është mbeturinat ku kisha me i sugjeruar drejtorisë përkatëse që vërtet të ketë kujdes në angazhimin më të madh për pastrimin e tyre.

**Mirsada Behluli**– tha se ne kemi pasur një takim me drejtorin Ilirik Musliu, i cili na ka njoftuar se edhe drejtorja ka probleme të trashëguara, pa kontejnerë, pa kamionë dhe ato janë në fazë të realizimit të cilat duhet të zgjidhen. Ai në vazhdim tha se konkretisht kemi të bëjmë me lagjen Kalabria, ku ka shumë pak lokacione për kontejnerë, ku për shkak të mungesës së kontejnerëve mbeturinat hedhen në një vend. Ai në vazhdim tha se ne e përcjellim situatën afërsisht gjithmonë ajo zbrazet, mirëpo prapë shumë shpesh vjen në atë gjendje edhe pse zbrazet rregullisht dhe jo vetëm në Kalabri, por unë e thash konkretisht për Kalabri sepse unë e di dhe besoj se në krejt lagjet, si në Bërnice të Poshtme, secili anëtar ka ankesa për këtë dhe është problem i përgjithshëm dhe jo vetëm i komuniteteve. Kjo do të ishte e tëra nuk do t'ju kisha ngarkuar dhe mbajtur më shumë. Tani ju falënderoj shumë që hapët rrugën e bashkëpunimit, si dhe të gjitha problemet tona mund t'i diskutojmë dhe t'i shkëmbejmë përmes emailit dhe mënyrave tjera që të jemi sa më efektiv, ku edhe ju sipas mundësive tuaja të na ndihmoni.



### **Pika e tretë**

#### **Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023**

Njëzëri u miratua Raporti vjetor i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023.

### **Pika e katërt**

#### **Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës të Komitetit për vitin 2024**

**Mirsada Behluli** – lidhur me planin e punës së Komitetit për Komunitete tha se unë së bashku me z. Nenad dhe znj. Kimete kemi punuar në hartimin e planit të punës së komitetit, të gjithë e keni marr materialin dhe ju kisha pyetur se a keni diçka të shtoni apo të hiqni.

Njëzëri u miratua Plani i punës i Komitetit për Komunitete për vitin 2024.

### **Pika e pestë**

#### **Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të ZKKK-ës për vitin 2023**

Kjo pikë e rendit të ditës mbetet të diskutohet në muajin janar 2024.

### **Pika e gjashtë**

#### **Projektet e komuniteteve joshumicë për vitin 2024, për investime kapitale të sillen në muajin janar në ZKKK**

**Mirsada Behluli** - tha se për investimet kapitale të dorëzohen në muajin janar të vitit 2024 në ZKKK.

### **Pika e shtatë**

#### **Raporti i ZKKK-s për muajin nëntor 2023**

**Klaudia Mula** - Përhëndetje për Kryesuesin, përhëndetje për të gjithë. Sa i përket Raportit vjetor të zyrës për komunitete, tha se raporti vjetor zakonisht dorëzohet në muajin janar, ndërsa sa i përket raportit mujor për muajin nëntor, tha se besoj se e keni lexuar të gjithë, por e kisha bërë një përmbledhje për disa aktivitete më të rëndësishme që kanë qenë gjatë këtij muaji. Si aktivitet shumë i rëndësishëm ka qenë përditësimi i listave të familjeve të cenueshme për t' i ndihmuar gjatë sezonit të dimrit, me mjete financiare nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me përfaqësuesit e komuniteteve. Kemi pasur një ankesë nga një anëtare e komitetit serb lidhur me ndërrimin e linjës së autobusëve. Zyra për komunitete ankesën e ka deleguar tek organet kompetente, siç është Drejtoria e Shërbimeve Publike. Pastaj janë organizuar disa fushata, sa i përket komitetit: rom, ashkali, egjiptian, fushata të parapara nga Plani lokal i veprimit për avancimin e këtyre komuniteteve. Kisha pasur një falënderim të veçantë për zyrën e kuvendit, lidhur me bashkëpunimin që kemi pasur. Ajo në vazhdim tha se Komuna e Prishtinës është vlerësuar si një prej komunave të para që ka miratuar Planin e veprimit, për të drejtat e komitetit: rom, ashkali dhe egjiptian, që është konstatuar me një konferencë që e kemi mbajtur, gjatë muajit nëntor, në Hotel Emerald, nga zyra për qeverisje të mirë. Ajo mes tjerash tha se gjatë implementimit të planit kisha pasur një thirrje nga përfaqësuesit për komitetin rom dhe ashkali, që të jenë më shumë pjesëmarrës në këto aktivitete që



organizohen nga drejtoritë përkatëse, si dhe njëherazi ceku edhe ankesën nga një anëtar i komunitetit turk, që ka të bëjë me ndarjen e atyre shtëpizave në Sheshin “Edit Durham”, me ankesën se pretendon se i është bërë një e padrejtë. Zyra për komunitete ka kërkuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, duke kërkuar sqarim në lidhje me këtë ankesë dhe sipas atij sqarimi çdo gjë ka shkuar në mënyrë transparente dhe pala e cekuar nuk ka aplikuar në afatin me kohë për ta fituar atë shtëpizë, nga e cila ka qenë thirrja. Kjo do të ishte një përmbledhje e raportit të muajit nëntor, nëse keni ndonjë pyetje.

**Nenad Miladinovic** - tha se do e kisha falënderuar znj. Klaudia për angazhimin dhe punën kur janë në pyetje kërkesat e komuniteteve, ndërsa sa i përket linjës së autobusit tha se për shkak të asfaltimit të rrugës në Bërnicën e Poshtme para dhjetë ditëve kam kontaktuar drejtorin për çështje teknike z. Mentor që linja e autobusit të vihet pjesërisht që qytetarët të përdorin atë linjë, kushtet ekzistojnë që deri në fillim të fshatit të vjen transporti pasi që Bërnica është një vend i madh dhe ka shumë qytetarë që e shfrytëzojnë atë transport dhe se është pjesë bukur e madhe prej Bërnicës deri në Bardhosh dhe nuk është mirë që qytetarët të ecin deri në Bardhosh pasi që është pjesë e gjatë deri në 2 km. Pra shpresoj se kjo duhet të rregullohet meqë e kemi edhe kryesuesin këtu dhe shpresoj se mund të na ndihmojë të apelojmë të paktën që pjesërisht të vihet ajo linjë që kishte me i plotësuar kushtet e qytetarëve.

**Oktay Kurtesh:** lidhur me çështjen e një qytetari të komunitetit turk tha se as unë nuk jam saktësisht në ngjarje mirëpo qysh më ka thënë se aplikimi për shtëpiza ka filluar më datën 25 dhjetor kurse ai ka aplikuar më datën 26 dhjetor si dhe i është thënë se për një ditë kanë pasur mundësi me i marr shtëpizat që d.m.th ky është vonuar.

Meqë tri herë ka aplikuar dhe ka ardhur në përfundim ku thotë se veç se jam i komunitetit turk nuk më është ndarë shtëpiza.

**Klaudia Mula** - tha se afati kohor për aplikim ka qenë nga data 25 deri me 8, mirëpo ka qenë si kriter afati kohor që nënkupton se ai i cili aplikon i pari do ta përfitojë shtëpizën dhe ai ka aplikuar një ditë mbrapa dhe nuk është përzgjedhur. Zyra për komunitete e ka njoftuar palën që të shfrytëzojë të drejtën e tij për ankesë duke e këshilluar. Lidhur me këtë mund ta ftojme edhe shefen për planifikim për të sqaruar më tutje. Ju e dini se zyra për komunitete gjithmonë ju dërgon drejtorive përkatëse shkresa për përkrahjen e komuniteteve për projekte të caktuara, qoftë edhe projekte subvencionale.

## **Pika e tetë**

### **Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë, lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre**

**Oktay Kurtesh** - duke u prezantuar si përfaqësues i komunitetit turk, jeton në lagjen ku jetojnë numri më i madh i komunitetit turk pra rrugës për Gërmë, menjëherë tek Muzeu i Kosovës, në ç’rast tha se sa i përket sigurisë nuk kanë probleme vetëm se problemi kryesor është punësimi i komunitetit turk në komunë pasi që vetëm dy pjesëtarë të komunitetit turk punojnë në Komunën e Prishtinës, e ata janë Nebahat Bejtullah e cila punon në Drejtorinë e Arsimit dhe Elvane Gashi e cila punon në Sektorin e ofiqarisë. Po ashtu problemi tjetër është se nuk kemi përfaqësues të komunitetit turk në asamble komunale, mirëpo besoj se arsyeja është se ndoshta nuk kemi përkthyes në gjuhën turke në Komunën e Prishtinës.

**Faton Marolli** - jam përfaqësues i komunitetit ashkali, jetoj në “Kodrën e Trimave”, shumica e këtij komuniteti janë në “Kodrën e Trimave”, një pjesë në lagjen “Kolovica”, te Kisha. Sa i përket sigurisë nuk kemi probleme, vetëm se problemi kryesor janë vendosja e shportave të mbeturinave. Kishte me qenë mirë të vendosen shportat sepse prej komunës deri në shtëpi e kam fiks 1 km, asnjë shportë nuk gjendet në rrugë.



E di që është kërkesë shumë e madhe dhe që është problematike për disa shporta për 1 km, të paktën dy shporta mjaftojnë.

**Nenad Miladinovic** - tha se po e shoh se është problem i madh shportat për mbeturina, me këto mjetet e investimeve kapitale e kemi përfunduar procesin e blerjes për shporta dhe kontejnerë. Të gjitha komunitetet e kanë këtë problem, 250 shporta për mbeturina i kemi siguruar, i kemi bërë për të gjithë komunitetet jo vetëm për serbët, por për secilën shtëpi.

**Kryesuesi** - sa i përket problemit të mbeturinave tha se javën e kaluar kuvendi e ka miratuar një Rregullore për planin për mbeturina për vitin 2023-2027, ku është një plan i detajuar, ku do të kyçet edhe sektori privat për mbledhjen e mbeturinave për herë të parë, projekti do të fillojë në shkurt të vitit tjetër kalendarik. Kompania "Pastrimi" ka marrë edhe subvencion, diku 1,500,000.00 euro, (1.5 milion euro), me të cilat do të blejë kamionë të rinj dhe përfundimisht besoj se do të kalojmë këtë fazën e tenderimit të shportave. Sektori privat do të operojë në qendrën e qytetit, ndërsa Kompania "Pastrimi", do të operojë kryesisht në rrethinë dhe fshatra. Besoj se është një projekt që ka zgjatur pak shumë, për shkak të interesave që ka pasur Kompania "Pastrimi", Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe sektori privat. Andaj po mendoj se viti tjetër këtë problematikë do ta gjejë në një fazë shumë të mirë dhe përfundimisht po mendoj se kemi me e largu.

**Mirsada Behluli** - si përfaqësuese e komunitetit boshnjak tha se sa i përket çështjes së sigurisë, banorët boshnjakë nuk kanë asnjë problem në lagjen e tyre, janë të shpërndarë në tërë Prishtinën. Mirëpo do t'ju kisha dhënë disa të dhëna të cilat janë të rëndësishme, e të cilat i kam marr nga OSCE dhe është mirë t'i shënoni: komuniteti ashkali ka 568 anëtarë, komuniteti romë ka 56 anëtarë, komuniteti serb ka 430 anëtarë, mirëpo sipas gjasave nuk janë nënshkruar të gjithë dhe të dhënat nuk janë të sakta, komuniteti boshnjak ka 400 anëtarë, komuniteti goran ka 205 anëtarë, komuniteti turk ka 1200 anëtarë.

#### **Pika e nëntë Të ndryshme**

**Mirsada Behluli** -shtroi shqetësimin e dy motrave Zineta dhe Ifeta Nikoçevic, ku thuhet se kanë pasur shtëpinë e cila është emëruar si trashëgimi kulturore. Në vitin 2005 është djegur, kanë mbetur mbeturinat e kësaj shtëpie, i cili është vetëm material i mbeturinave, kurse ato vetë e kanë pastruar shtëpinë, kështu që me vite u janë drejtuar organeve kompetente. Mirëpo ky problem i kthimit të pronës dhe shfrytëzimit të pronës asnjëherë nuk është zgjedhur. Ato njëherazi ankohen se gjithmonë kanë konkurruar në institucionet e Kosovës dhe asnjëherë nuk iu është ofruar ndihmë, ndërkaq kërkesën e kanë protokolluar me 4.12.2023.

**Kryesuesi:** nëse mund të më dërgoni emailin.

**Mirsada Behluli** - patjetër kjo do të ishte përafërsisht e gjitha që e kemi në rendin e ditës. A keni ndonjë gjë në të ndryshme. Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime të tjera përveç urimet nga ana e anëtarëve të Komitetit për Komunitete për festat e fundvitit.

Pas shumë diskutimesh, propozimesh dhe sugjerimesh Komiteti për Komunitete nxori këtë:

## **KONKLUZION**

- Përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë t'i dorëzojnë projektet për investime kapitale në ZKKK.

Motrat Zineta dhe Ifeta Nikoçevic t'i drejtohen përmes e-maillit kryesuesit të Kuvendit lidhur me çështjen e pronës.

- Përfaqësuesi i komunitetit serb z Miladinovic ka informuar komitetin që për shkak të asfaltimit të rrugës të mundësohet pjesërisht qarkullimi i autobusit.

Procesmbatësja  
Lendita Spahija

Kryesuesja e Komitetit  
Dr. Mirsada Benfili

